



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 18. 03. 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Enis Kervan, Shaip Muja, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi, Amir Ahmeti, dhe Petar Miletic.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Besnik Ramadani – KDI dhe Sanije Berisha – OSBE.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti- kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Mbledhja konstituive e Komisionit

Albin Kurti – E paraqiti përbërjen e Komisionit prej nëntë anëtarëve, të themeluar në mbledhjen plenare të 10 marsit 2011. Shtoi se Komisioni do të punojë duke u mbështetur në Rregulloren e Kuvendit dhe në fushëveprimin e tij. Propozoi, që mbledhjet e Komisionit të mbahen në parim 2 herë në muaj, ditën e mërkurë, me mundësinë e organizimit të tyre edhe atëherë kur është e nevojshme.

Donika Kada Bujupi – E përkrahu propozimin e kryetarit të Komisionit, që mbledhjet të mbahen 2 herë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shpesh. Propozoi, që në takimin e radhës, secili nga anëtarët e Komisionit t'i paraqesë propozimet për aktivitetet e rregullta të Komisionit, me qëllim të hartimit të planit të Komisionit.

Sabri Hamiti - Njoftoi se ky Komision ka më pak punë legjislative se komisionet e tjera dhe është e mjaftueshme të mbahen 2 mbledhje në muaj. Veprimtaria e tij lidhet kryesisht me Ministrinë e Punëve të Jashtme, me Qeverinë dhe me Presidencën. Sa i përket planit të punës tha se duhet të bëhet një plan orientues, sepse nuk mund t'i caktojmë datat saktë. Propozoi të hartohet një plan pune deri në fund të këtij sesioni. Njoftoi se nga legjislatura e kaluar kanë mbetur të parealizuar dy vizita zyrtare, në Shqipëri dhe në Maqedoni, për të cilat ende ka kohë.

Amir Ahmeti - Tha se ky Komision, përveç që mund ta luajë rolin e këmbimit të përvojave me parlamentet e tjera, do të mund ta luante edhe rolin e lobimit. Duke e pasur parasysh se në botë ekzistojnë më se 30 parlamente ndërkombëtare, që i ngërthejnë në vete një sërë shtetesh, nëpërmjet kontaktit me këto parlamente, mund të llobohet për njohje të reja.

Enis Kervan – E Përkrah propozimin, që Komisioni të takohet dy herë në muaj, ditën e mërkurë dhe sipas nevojës të mbahen edhe mbledhje të tjera.

Skender Hyseni – Për planin e punës së Komisionit tha se duhet t'i përshtatet mundësive reale të Kosovës. Ky Komision do të duhej të vihej nën mbikëqyrje të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Propozoi që kryetari i Komisionit ta hartojë një propozim për një plan të shkurtër dhe konkret të punës, që do të shqyrtohej në Komision.

Shaip Muja - Tha se është mirë ta kemi një plan pune në bashkërendim me politikat e Qeverisë dhe të Presidencës. Propozoi që me rastin e hartimit të planit të punës së Komisionit të shqyrtohen përvojat e vendeve më të avancuara dhe ato t'i përshtaten nevojave tona në bashkërendim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Sabri Hamiti - Theksoi se ky Komision nuk e ka për detyrë ta krijojë politikën e jashtme të Kosovës, por ta korrektojë dhe ta ndihmojë atë në nivelin parlamentar. Përfaqësimin e jashtëm, sipas Rregullores së Kuvendit, e ushtron Kryesia e Kuvendit. Komisioni për Punë të Jashtme është komision funksional, që e përcjellë në radhë të parë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe përpiqet që në të gjitha takimet t'i projektojë interesat e Kosovës. Njëkohësisht është detyrë e këtij Komisioni ta shqyrtojë buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Albin Kurti - Tha se Komisioni veprimtarinë do ta ushtrojë duke u mbështetur në Rregulloren e Kuvendit, ndërsa për draftplanin e punë së Komisionit për këtë vit, do të diskutohet në mbledhjen e radhës.

Komisioni pas këtyre diskutimeve e nxori këtë

P e r f u n d i m

Konstituohet Komisioni funksional për Punë të Jashtme, i themeluar në mbledhjen plenare të 10 marsit 2011. Komisioni do të takohet në parim dy herë në muaj, ditën e mërkurë, duke filluar në orën 11. 00.

Mbledhja përfundoi në orën 10: 40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti